



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.140/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.03.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Kreatx” ShPK në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me nr. REF-82667-12-21-2020, me objekt: “*HR & Payroll për listëpagesat*”, me fond limit 6,500,000 lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 25.01.2021 nga autoriteti kontraktor Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A.

Ankimues: BOE “Infosoft Systems” ShPK & “Info Business Solution” ShPK
Rruga “Murat Toptani”, Gjergji Center, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A.
Rruga “Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë

12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.12.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me nr. REF-82667-12-21-2020, me objekt: “HR & Payroll për listëpagesat”, me fond limit 6,500,000 lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 25.01.2021 nga autoriteti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh. A.

II.2. Në datën 25.01.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Nga verifikimet në SPE, rezulton se në datën 02.02.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Kreatx	5,400,000	I kualifikuar
- Infosoft Systems	6,110,000	I kualifikuar

II.4. Në datën 08.02.2021 BOE “Infosoft Systems” ShPK & “Info Business Solution” ShPK ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- *Në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 3.2, modifikuar nëpërmjet shtojcës së publikuar në APP me emërtimin shtojcë për modifikim kriteresh Payroll 13.01.2021 autoriteti ndër të tjera kërkon: Për të garantuar cilësinë e punës gjatë instalimit / konfigurimit të sistemit të kërkuar , operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë në stafin e tij 3 muajt e fundit punonjësit si më poshtë vijon:*
- *1 (një) specialist të certifikuar për pajisjet Server të sistemit i pajisur me certifikimin përkatës (të lëshuar nga subjekte kombëtare të akredituara sipas legjislacionit në fuqi ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose nga prodhues të pajisjeve), i cili duhet të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit (Shtator- Tetor- Nëntor) shoqëruar me kontratë pune, diplomë në fushën IT teknologji informacioni/ inxhinieri elektronike/ inxhinier informatike/ inxhinieri telekomunikacioni/ informatikë ekonomike/ informatikë inxhinierike/ softuerike.*
- *1 (një) specialist të certifikuar për platformën aktuale të virtualizimit të përdorur në datacenterin e UKT i pajisur me certifikimin përkatës (të lëshuar nga subjekte kombëtare të akredituara sipas legjislacionit në fuqi ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose nga prodhuesi i pajisjeve), i cili duhet të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit (Shtator- Tetor- Nëntor) shoqëruar me kontratë pune, diplomë në fushën IT teknologji informacioni/ inxhinieri elektronike/ inxhinier informatike/ inxhinieri telekomunikacioni/ informatikë ekonomike/ informatikë inxhinierike/ softuerike.*
- *Në kërkesat e mësipërme shprehet qartë se për tu kualifikuar operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë të stafit e cila patjetër duhet të plotësojë një nga kushtet:*
- *Të lëshuara nga subjekte kombëtare të akredituara sipas legjislacionit në fuqi, ose*
- *Organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga RSH ose*
- *Nga prodhuesi i pajisjeve*

Referuar shtojcës 9 autoriteti shprehet se serverat ekzistues në përdorim nga UKT janë prodhuar nga prodhuesi HP dhe Platforma e Virtualizimit është prodhuar nga prodhuesi Microsoft.

Duke ju referuar eksperiencave të mëparshme të konkurrencës me operatorin ekonomik Freatex edhe në procedura të tjera prokurimi, kemi marrë informacion të mjaftueshëm që demonstroi se Kreatex X nuk ka personel i cili të plotësojë kriteret e mësipërme të kualifikimit për certifikimet përkatëse (të lëshuara nga subjekte kombëtare të akredituara sipas legjislacionit në fuqi ose organizma ndërkombëtare akredituese, të njohura nga RSH ose nga prodhuesi i pajisjeve).

Personeli i këtij operatori ekonomik në lidhje me staf të certifikuar për pajisjet server dhe platformën e virtualizimit nuk janë të certifikuar nga subjekte kombëtare të akredituara sipas legjislacionit në fuqi , nuk janë të certifikuar nga organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga RSH dhe as nga prodhuesit përkatës por janë të certifikuar nga kompani si Brainbench dhe Udemy.

Brainbench është një autoritet i pavarur certifikues nëpërmjet të cilit zhvillohen testimet për certifikime të niveleve të ndryshme , por ky autoritet nuk është prodhues, nuk është subjekt kombëtar sipas legjislacionit tonë përkatës dhe as nuk njihet si organizëm akreditues nga RSH.

Udemy nga ana tjetër është një kompani edukimi e cila ofron kurse trajnimi por gjithashtu nuk është prodhues, nuk është subjekt kombëtar sipas legjislacionit tonë përkatës dhe as nuk njihet si organizëm akreditues nga RSH. Argumentimet tona janë të bazuara në fakte të marra nga faqet zyrtare të prodhuesve, organizmave ndërkombëtare që ofrojnë trajnime si dhe nga DPA, ku në asnjë vend nuk vërtetohet përmbushja e kriterëve për certifikatë sipas kërkesave të autoritetit.

Gjithashtu referuar vendimeve të publikuara në faqen zyrtare të KPP , subjekti Kreatex ka paraqitur ankesë për modifikim të kriterëve të veçanta teknike, në procedura të mëparshme prokurimi me objekt të ngjashëm me objektin në fjalë. Konkretisht në procedura të mëparshme të prokurimit me kriteret të veçanta të ngjashme me objektin në fjalë (Certifikime të lëshuara nga prodhuesit e pajisjeve server etj.), vetë operatori Kreatx kërkon modifikimin e kriterit për lëshimin e certifikatave nga prodhuesi i pajisjeve “AK duhet të mbajë parasysh se certifikatat mund të lëshohen dhe nga organet e specializuara për certifikime të cilat duhet të merren parasysh. Gjithashtu në vlerësimin tonë në kriteret e sipërcituara pas termit prodhues edhe termi distributor i autorizuar.

Qartazi, bazuar mbi këtë kërkesë të operatorit Kreatx , vërtetohet më së miri se ky operator nuk zotëron certifikatë të lëshuara nga prodhuesi/t por nga organe të specializuara për certifikime të cilat as në objektin e prokurimit të sipër përmendur nuk plotësojnë kushtet e vendosura nga AK.

Duke prezumuar se edhe për këtë prokurim certifikimet e operatorit Kreatx janë nga Brainbench dhe Udemy, është përgjegjësi e AK që të vlerësojë këtë operator në

përmbushje me kërkesat e tenderit, vetëm nëse subjekti së bashku me certifikatat ka paraqitur dokumente provuese në rast se Brainbench dhe Udemy janë të njohur nga prodhuesi i pajisjeve HP apo për platformën e Virtualizimit nga Microsoft, apo nga organet certifikues janë të akredituar nga RSH.

Për sa më lart ju lutem të bëni rivlerësimin e operatorit ekonomik Kreatx duke e skualifikuar për mospërmbushje kriteresh kualifikimi të vendosura në DT dhe shtojcën e publikuar në respektim të dispozitave të LPP.

II.5. Me shkresën nr.2170/1 prot datë 15.02.2021 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje BOE ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.6. Në datën 23.02.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë drejtuar autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.K-562/1 prot datë 04.03.2021 protokolluar me tonën me nr.312/2 prot datë 05.03.2021 me objekt “*Dërgohet informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në zbatim të nenit 30 pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, në të cilin parashikohet se “*1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përgjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre*”, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.1. Marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit lidhur me skualifikimin nga procedura e prokurimit të operatorit ekonomik “Kreatx” ShPK, nga verifikimi i kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, të bazë të të cilave është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i

ofertave, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, këto kritere janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, të cilat shkaktojnë konfuzion e paqartësi në mënyrën e përmbushjes së tyre, e konkretisht vëren se:

III.1.2. Në shtojcën “modifikim mbi dokumentet e tenderit” të procedurës së prokurimit objekt ankimi, përcaktohet si më poshtë:

3.2.Për të garantuar cilësinë e punës gjatë instalimit / konfigurimit të sistemit të kërkuar , operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë në stafin e tij 3 muajt e fundit punonjësit si më poshtë vijon:

- *2 (dy) specialist të certifikuar për zhvillim softuer i pajisur me certifikimin përkatës (të lëshuar nga subjekte kombëtare të akredituara sipas legjislacionit në fuqi ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë) , të cilët duhet të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit (Shtator-Tetor- Nëntor) shoqëruar me kontratë pune, diplomë në fushën IT teknologji informacioni/ inxhinieri elektronike/ inxhinier informatike/ inxhinieri telekomunikacioni/ informatikë ekonomike/ informatikë inxhinierike/ softuerike.*
- *1 (një) specialist te certifikuar për pajisjet Server te sistemit i pajisur me certifikimin përkatës (të lëshuar nga subjekte kombëtare të akredituara sipas legjislacionit në fuqi ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë), i cili duhet të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit (Shtator- Tetor- Nëntor) shoqëruar me kontratë pune, diplomë në fushën IT teknologji informacioni/ inxhinieri elektronike/ inxhinier informatike/ inxhinieri telekomunikacioni/ informatikë ekonomike/ informatikë inxhinierike/ softuerike.*
- *1 (një) specialist te certifikuar për platformën aktuale të virtualizimit të përdorur ne datacenterin e UKT i pajisur me certifikimin përkatës (të lëshuar nga subjekte kombëtare të akredituara sipas legjislacionit në fuqi ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë), i cili duhet të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit (Shtator- Tetor- Nëntor) shoqëruar me kontratë pune, diplomë në fushën IT teknologji informacioni/inxhinieri elektronike/ inxhinier informatike/inxhinieri telekomunikacioni/informatikë ekonomike/informatikë/ inxhinierike softuerike.*
- *1 (një) specialist të certifikuar PMI ose ekuivalente për menaxhimin e projektit, (të lëshuar nga subjekte kombëtare të akredituara sipas legjislacionit në fuqi ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë) i cili duhet të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit (Shtator- Tetor- Nëntor) shoqëruar me kontratë pune.*

Bëhet:

3.2.Për të garantuar cilësinë e punës gjatë instalimit / konfigurimit të sistemit të kërkuar , operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë në stafin e tij 3 muajt e fundit punonjësit si më poshtë vijon:

- *2 (dy) specialist të certifikuar për zhvillim softuer i pajisur me certifikimin përkatës (të lëshuar nga subjekte kombëtare të akredituara sipas legjislacionit në fuqi ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose nga prodhues të pajisjeve) , të cilët duhet të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit (Shtator- Tetor- Nëntor) shoqëruar me kontratë pune, diplomë në fushën IT teknologji informacioni/ inxhinieri elektronike/ inxhinier informatike/ inxhinieri telekomunikacioni/ informatikë ekonomike/ informatikë inxhinierike/ softuerike.*
- *1 (një) specialist të certifikuar për pajisjet Server të sistemit i pajisur me certifikimin përkatës (të lëshuar nga subjekte kombëtare të akredituara sipas legjislacionit në fuqi ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose nga prodhues të pajisjeve), i cili duhet të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit (Shtator- Tetor- Nëntor) shoqëruar me kontratë pune, diplomë në fushën IT teknologji informacioni/ inxhinieri elektronike/ inxhinier informatike/ inxhinieri telekomunikacioni/ informatikë ekonomike/ informatikë inxhinierike/ softuerike.*
- *1 (një) specialist të certifikuar për platformën aktuale të virtualizimit të përdorur në datacenterin e UKT i pajisur me certifikimin përkatës (të lëshuar nga subjekte kombëtare të akredituara sipas legjislacionit në fuqi ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose nga prodhuesi i pajisjeve), i cili duhet të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit (Shtator- Tetor- Nëntor) shoqëruar me kontratë pune, diplomë në fushën IT teknologji informacioni/ inxhinieri elektronike/ inxhinier informatike/ inxhinieri telekomunikacioni/ informatikë ekonomike/ informatikë inxhinierike/ softuerike.*
- *1 (një) specialist të certifikuar PMI ose ekuivalente për menaxhimin e projektit, (të lëshuar nga subjekte kombëtare të akredituara sipas legjislacionit në fuqi ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë ose nga prodhuesi i pajisjeve) i cili duhet të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit (Shtator- Tetor- Nëntor) shoqëruar me kontratë pune.*

III.1.3. Në nenin 20 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.*

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti*

kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 28/2 të VKM 914/2014 përcakohet se: *“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Neni 21 i ligjit Nr. 15/2017 *“Për Arsimin Dhe Formimin Profesional Në Republikën E Shqipërisë”*, parashikohet se :

- 1. Kompetencat e përftuara nga arsimi dhe formimi profesional joformal dhe informal vlerësohen në përputhje me standardet e profesioneve për kualifikimet profesionale.*
- 2. Procedurat e vlerësimit e të certifikimit miratohen nga ministri përgjegjës për AFP-në.*
- 3. Në rastet e individëve që kanë marrë një certifikatë, diplomë apo titull jashtë vendit, njësimi kryhet nga ministria përgjegjëse për AFP-në, në bazë të rregullave të miratuara nga ministri përgjegjës për AFP-në.*
- 4. Sistemi i njohjes të të nxëniet të mëparshëm joformal dhe informal rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.*

III.1.4. Sa më sipër analizuar, gjykojmë se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriterin e veçantë të vendosur.

III.1.5. Lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor mbi certifikatat që duhet të disponohen nga operatorët pjesëmarrës, KPP vëren se në tërësi kriteri i hartuar nga autoriteti kontraktor është konfuz dhe i papërcaktuar qartë. Konkretisht sa i takon kriterit lidhur me specialist të certifikuar për pajisjet Server të sistemit i pajisur me certifikimin përkatës (të lëshuar nga subjekte kombëtare të akredituara sipas legjislacionit në fuqi ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose nga prodhues të pajisjeve), KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka vënë subjektet në pozita pabarazie pasi nga njëra anë ka kërkuar certifikata të akredituara sipas legjislacionit në fuqi ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe nga ana tjetër kërkon certifikata të lëshuara thjesht nga prodhuesi. KPP gjykon se me këtë kriter autoriteti kontraktor ka diskriminuar operatorët ekonomikë duke shkelur parimin e mosdiskriminimit dhe barazisë së kandidatëve dhe parimit të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë duke u ngarkuar të njëjtat të drejta dhe detyrime. Kjo për shkak se një certifikatë e lëshuar nga prodhuesi i pajisjeve cili mund të mos jetë i certifikuar për trajnimin e punonjësve, nuk mund të jetë e njëjtë me një certifikatë të lëshuar nga një organizëm trajnues i akredituar kombëtarisht dhe akoma më tej ndërkombëtarisht.

Akoma më tej, KPP gjykon se në rastin konkret kriteri nuk është hartuar në përputhje me ligjin e posaçëm për arsimin profesional e konkretisht nenin 21 të tij i cili në pikën 3 të tij parashikon se *Në rastet e individëve që kanë marrë një certifikatë, diplomë apo titull jashtë vendit, njësimi kryhet nga ministria përgjegjëse për AFP-në, në bazë të rregullave të miratuara nga ministri përgjegjës për AFP-në.* Në këto kushte, KPP gjykon se kriteri i hartuar nga autoriteti kontraktor ka shkaktuar konfuzion në radhët e operatorëve ekonomikë lidhur me mënyrën e përmbushjes së këtij kriteri, referuar edhe pjesëmarrjes së ulët të operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit objekt ankimi, ndërkohë që kriteret e kualifikimit duhet të jenë të tilla që të vendosin të gjithë pjesëmarrësit në pozita barazie duke u ngarkuar të njëjtat të drejta dhe detyrime. Vlen të theksohet se, kriteret e kualifikimit, nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt prokurimi me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit. Mospërcaktimi i saktë i kriterit të mësipërm, shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, bazuar në nenin 64, pika 3 të LPP – së, gjykon se situata diskriminuese e krijuar nga moszbatimi i nenit 20 të LPP si dhe mospërcaktimi i qartë i kriterit të kualifikimit, përbën shkak për anulimin e kësaj procedure prokurimi. Në nenin 31, pika 2 gërma “d” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, parashikohet se: “[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar: d) Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor për rifillimin e procedurës së prokurimit [...]”. Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes nuk do të merren në shqyrtim në themel, pasi procedura e prokurimit duhet të anulohet për shkaqet e sipërcituara.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga BOE “Infosoft Systems” ShPK & “Info Business Solution” ShPK për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me nr. REF-82667-12-21-2020, me objekt: “HR & Payroll për listëpagesat”, me fond limit 6,500,000 lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 25.01.2021 nga autoriteti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.A.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Infosoft Systems” ShPK & “Info Business Solution” ShPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.312 Protokolli; Datë 23.02.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Merita Zeqaj

Anëtar
Lindita Skeja

Kryetar
Jonaid Myzyri